

LIGJ
Nr.7732, datë 20.7.1993

PËR VENDOSJEN E MBITAKSËS DOGANORE PËR MALLRAT E IMPORTIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Të gjitha mallrat e importuara në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen mbitaksës së detyrueshme doganore në masën 5 për qind të vlerës së tyre doganore. Kjo mbitaksë zbatohet veç nga taksat normale të importit dhe prej saj përjashtohen gruri e mielli.

Neni 2

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ngarkohet të nxjerrë udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.605, datë 29.7.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.